



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2685/5 prot.

Datë 21.10.2025

**V E N D I M**  
**Nr. 1491/2025**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

|                  |            |
|------------------|------------|
| Fiorent Zguro    | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar     |
| Anila Malaj      | Anëtar     |
| Gjergj Mersini   | Anëtar     |

Në mbledhjen e datës 21.10.2025 me

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-56502-07-29-2025, me objekt: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 16,956,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 29.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik, “Krijon” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Autoriteti Kontraktor:**

Operatori i Blerjeve të Përqendruara me adresë Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Pegasus” SHPK,, me NIPT J62903750A dhe adresë: Rruga Siri Kodra, tek ish frigoriferi, Nr. 149, Tiranë.

Operatori ekonomik “Krijon” SHPK me NIPT K12023001A dhe adresë: Rruga e Elbasanit, nr.57, Collak, 1044, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përllëguaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 30.07.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-56502-07-29-2025, me objekt: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 16,956,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 29.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 29.08.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 16.09.2025, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

|             |            |      |              |
|-------------|------------|------|--------------|
| Pegasus     | 7,780,000  | lekë | Skualifikuar |
| Bionic Tech | 10,900,000 | lekë | Skualifikuar |
| Krijon      | 10,900,000 | lekë | Skualifikuar |
| Medfau      | 12,900,000 | lekë | Kualifikuar  |

II.4 Në datën 25.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 30.09.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2025/5870 dhe me nr. 2685 prot., datë 30.09.2025, i operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2685/1 prot, datë 01.10.2025.

II.5.2. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 2364/8 prot., datë 08.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2685/2 prot., datë 10.10.2025, ka dërguar vendimin e KSHA, Nr.104/2025, datë 08.10.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Pegasus” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i

fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.6.Në datën 03.10.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr.A/2025/5890 dhe me nr. 2738 prot., datë 06.10.2025, i operatorit ekonomik “Krijon”SHPK, lidhur me kundërshtimin e vendimit të komisionit të vleresimit të ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK, nga procedura e prokurimit të sipërcituar

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2738/1 prot, datë 07.10.2025.

II.6.2. Autoriteti kontraktor, nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, me shkresën nr. 2364/9 prot., datë 14.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2738/2 prot., datë 14.10.2025, ka dërguar vendimin e KSHA Nr.112/2025, datë 14.10.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton se, ky i fundit, ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.6.3. Autoriteti kontraktor ka dërguar edhe nëpërmjet shërbimit postar pranë KPP vendimin e KSHA Nr.112/2025, datë 14.10.2025, protokolluar me tonën me nr.2738/3 prot., datë 16.10.2025, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara sipas parashikimeve të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Pegasus” SHPK, për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: “*Operatori ekonomik “PEGASUS”*”

*sh.p.k, me Nuis J81609010U nuk përmbushi kërkesat për kualifikim sipas pikës 2, të Seksionit 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, Kërkesat e Vecanta për Kualifikim , Shtojca 8 e DT, në lidhje me detyrimin për paraqitjen e raporteve të auditit ligjor të pasqyrave financiare të viteve 2022 dhe 2024”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Në shtojcën 8 “Formulari i kritereve të përzgjedhjes/kualifikimit”, kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.2, rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon:

*2.2.2.Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

III.1.2. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Pegasus” SHPK. ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Shkresën nr. 640 prot., datë 29.06.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me lëndë “Konfirmim”, drejtuar subjektit “Pegasus” SHPK me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me datë 26.06.2023, dorëzuar në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, me objekt “Kërkesë për konfirmim të pasqyrave financiare të vitit 2022 dhe raportin e audituesit ligjor”, ju konfirmojmë bashkëlidhur kopje të tyre deklaruar nga ana juaj online në sistemin tatimor C@TS në dataën 31.03.2022”.
- Pasqyra Financiare viti 2022.
- Shkresën nr. 636 prot., datë 28.06.2024 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me lëndë “Konfirmim”, drejtuar subjektit “Pegasus” SHPK me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me datë 25.06.2024, dorëzuar në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, me objekt “Kërkesë për konfirmim të pasqyrave financiare të vitit 2023 dhe raportin e audituesit ligjor”, ju konfirmojmë bashkëlidhur kopje të tyre deklaruar nga ana juaj online në sistemin tatimor C@TS në dataën 12.04.2024”.
- Pasqyra Financiare viti 2023, shoqëruar me raportin e audituesit ligjor (për vitin financiar 2023).
- Shkresën nr. 257 prot., datë 10.04.2025 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me lëndë “Konfirmim”, drejtuar subjektit “Pegasus” SHPK me përmbajtje si vijon: “Në përgjigje të kërkesës tuaj me datë 08.04.2025, dorëzuar në Drejtorinë e Shërbimit të Tatimpaguesve të Mëdhenj, me objekt “Kërkesë për konfirmim të pasqyrave financiare të vitit 2024 dhe raportin e audituesit ligjor”, ju konfirmojmë bashkëlidhur kopje të tyre deklaruar nga ana juaj online në sistemin tatimor C@TS në dataën 28.03.2025”.
- Pasqyra Financiare viti 2024.

III.1.3 Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

Në neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në nenin 21, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, thuhet shprehimisht: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”*

Në nenin 77, pika 1 dhe 3 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
  - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
  - c) aftësinë teknike dhe profesionale.*
  - Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*
- 2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.*

*Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.*

*3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

*Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

*Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës. Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

*Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*

*5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

*Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

*III.1.4. Në nenin 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .*

*2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit .

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. ”

III.1.5. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, edhe kopje të certifikuara të bilanceve të viteve (2022,2023,2024), të paraqitura dhe të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore dhe të shoqëruara me Akt ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar nëse ndodhet në kushtet e parashikura nga ligji sektorial.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik ankimues “Pegasus” SHPK ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), dokumentacionin e përmendur në pikën III.1.2. të këtij vendimi, pra Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2022, Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2023, Pasqyrat financiare për vitin ushtrimor 2024, si dhe shkresat e lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për konfirmimin e pasqyrave financiare drejtuar subjektit “Pegasus” SHPK.

Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor, kriterit 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, si dhe arsye së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Pegasus” SHPK se “Operatori ekonomik “PEGASUS” sh.p.k, me Nuis J81609010U nuk përmbushi kërkesat për kualifikim sipas pikës 2, të Seksionit 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar, Kërkesat e Vecanta për Kualifikim , Shtojca 8 e DT, në lidhje me detyrimin për paraqitjen e raporteve të auditit ligjor të pasqyrave financiare të viteve 2022 dhe 2024”, vihet re se operatori ekonomik “Pegasus” SHPK ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, i ligjit nr.10091, datë 5.3.2009, ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, por KPP gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar, ka dhënë një indicie që plotëson kriterin 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe se bazuar në nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se “ Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i 130 kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, autoriteti kontraktor ka patur në dispozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK. Sa më sipër, nëse autoriteti kontraktor kishte dyshime lidhur me dokumentacionin e dorëzuar duhet ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Pegasus” SHPK qëndron pjesërisht.

II.2.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Krijon” SHPK, për kundërshtimin e skualifikimit të tij me arsyetimin se: “ Operatori ekonomik “KRIJON” sh.p.k., me Nipt K12023001A nuk përmbushi kërkesat për kualifikim sipas pikës 2, të Seksionit 2.2. “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, Kërkesat e Vecanta për Kualifikim , Shtojca 8 e DT, në lidhje me detyrimin për paraqitjen e raporteve të auditit ligjor të pasqyrave financiare të vitit 2024, si më poshtë vijon: Në Pikën 2, Seksioni 2.2 Kapaciteti Ekonomik dhe Financiar , Shtojca 8 e DT është kërkuar “Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2022, 2023, 2024) të konfirmuara nga autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore”, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Për këtë pikë subjekti “KRIJON” sh.p.k, nuk paraqiti raportet e auditit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2024 megjithëse këto dokumentet janë përcaktuara shprehimisht në

*dokumentat e tenderit si dokumente të detyrueshme për kualifikim për tu paraqitur”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Krijon” SHPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE), dokumentacionin si më poshtë:

- Shkreën nr. 572 prot., datë 27.04.2023 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me lëndë *“Kthim përgjigje”*, drejtuar subjektit “Krijon” SHPK me përmbajtje si vijon: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr ceshtje E0001081777, datë 14.04.2023, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj , në sistemin informatik tatimor për vitet:*
- *Viti 2022 të dorëzuara elektronikisht, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, më datë 21.03.2023.*
- Pasqyra Financiare viti 2022, shoqëruar me raportin e audituesit të pavarur (për vitin financiar 2022).
- Shkreën nr. 6009 prot., datë 04.04.2024 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me lëndë *“Kthim përgjigje”*, drejtuar subjektit “Krijon” SHPK me përmbajtje si vijon: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr ceshtje E0001228474, datë 29.03.2024, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj , në sistemin informatik tatimor për vitet:*
- *Viti 2023 të dorëzuara elektronikisht, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, më datë 29.03.2024.*
- Pasqyra Financiare viti 2023, shoqëruar me raportin e audituesit të pavarur (për vitin financiar 2023).
- Shkreën nr. 6806 prot., datë 08.04.2025 lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me lëndë *“Kthim përgjigje”*, drejtuar subjektit “Krijon” SHPK me përmbajtje si vijon: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr ceshtje E0001407829, datë 27.03.2025, po ju vëmë në dispozicion në formatin PDF, kopje të pasqyrave financiare të depozituara nga ana juaj , në sistemin informatik tatimor për vitet:*
- *Viti 2024 të dorëzuara elektronikisht, pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, më datë 26.03.2025.*
- Pasqyra Financiare viti 2024.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në SPE rezulton se operatori ekonomik ankimues “Krijon” SHPK ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), dokumentacionin e sipërpërmendur.

Referuar kërkesës së autoritetit kontraktor, kriterit 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar, si dhe arsye së skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Krijon” SHPK se *“subjekti “KRIJON” sh.p.k, nuk paraqiti raportet e auditit ligjor të pasqyrave financiare vjetore për vitin 2024”*, vihet re se operatori ekonomik “Krijon” SHPK ndodhet në kushtet e parashikuara nga neni 41, pika ”c”, i ligjit nr.10091, datë 5.3.2009, *“Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”*, i ndryshuar, por KPP gjykon se me dokumentacionin e dorëzuar, ka dhënë një indicie që plotëson kriterin 2.2.2 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe se bazuar në nenin 82 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për*

*miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar në të cilin përcaktohet se “ Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i. “Devijimi” është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. “Rezervimi” është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i 130 kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë”, autoriteti kontraktor ka patur në dispozicion momentin procedural për kryerjen e verifikimeve apo kërkimin e sqarimeve operatorit ekonomik “Krijon” SHPK. Sa më sipër, nëse autoriteti kontraktor kishte dyshime lidhur me dokumentacionin e dorëzuar duhet ti kërkonte sqarime operatorit ekonomik.*

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Krijon” SHPK qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Pegasus” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-56502-07-29-2025, me objekt: “Blerje Gazkromatograf Bidimensional për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave”, me fond limit 16,956,000.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me date 29.08.2025 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Krijon” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorëve ekonomikë “Pegasus” SHPK dhe “Krijon” SHPK dhe të korigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
  4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  5. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Pegasus” SHPK dhe “Krijon” SHPK .
  6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Gjergj Mersini**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

